



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS
KOMISIONI KONKURRENCËS

Nr. 346/ prot.

Tiranë, më 26.09.2025

VENDIM

Nr. 1217, Datë 26.09.2025

MBI MIRATIMIN E RREGULLORES
“PËR PËRJASHTIMIN E DISA KATEGORIVE TË MARRËVESHJEVE TË KËRKIMIT
DHE ZHVILLIMIT”

Komisioni i Konkurrencës me pjesëmarrjen e:

Z.	Denar BIBA	Kryetar
Znj.	Leida MATJA	Zv/Kryetar
Z.	Durim KRAJA	Anëtar
Znj.	Fatjola DELIJA	Anëtar

Në mbledhjen e tij të datës 26.09.2025, shqyrtoi çështjen me:

Objekt: Mbi miratimin e Rregullores “Për përjashtimin e disa kategorive të marrëveshjeve të kërkimit dhe zhvillimit”.

Baza Ligjore: Neni 24, shkronja (d) dhe neni 26 i Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”.

Komisioni i Konkurrencës, pas shqyrtimit të:

- Relacionit të Sekretarit të Përgjithshëm të Autoritetit të Konkurrencës;
- Draft - rregullores “Për përjashtimin e disa kategorive të marrëveshjeve të kërkimit dhe zhvillimit”

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për përjashtimin e disa kategorive të marrëveshjeve të kërkimit dhe zhvillimit”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm për zbatimin e këtij vendimi.


Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I KONKURRENCËS

Leida MATJA


Zv/Kryetar

Durim KRAJA


Anëtar

Fatjola DELIJA


Anëtar

Denar BABA


Kryetar



RREGULLORE

**“PËR PËRJASHTIMIN E DISA KATEGORIVE TË MARRËVESHJEVE TË KËRKIMIT
DHE ZHVILLIMIT”¹**

Neni 1

Objekti dhe qëllimi

1. Kjo Rregullore ka si objekt përcaktimin e kushteve që duhet të përmbushin marrëveshjet e kërkit dhe zhvillimit për të përfituar përjashtim nga ndalimi i nenit 4 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar (referuar ne vazhdim si “Ligji”), në përputhje me nenin 5 dhe 6 të tij.
2. Autoriteti i Konkurrencës nxit ndërmarrjet në veprimtaritë e tyre të kërkim – zhvillimit teknologjik si dhe mbështet përpjekjet e tyre për bashkëpunim me njëra – tjetrën.
3. Përjashtimi i vendosur nga kjo Rregullore nuk duhet të zbatohet për marrëveshjet që përmbajnë kufizime të cilat nuk janë të domosdoshme për arritjen e efekteve pozitive të krijuara nga një marrëveshje kërkimi dhe zhvillimi.
4. Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë marrëveshjet e kërkim zhvillimit të cilat përjashtohen, të vlerësojë ndikimin e këtyre marrëveshjeve në tregun përkatës si dhe të përcaktojë rastet kur këto marrëveshje nuk janë objekt përjashtimi.

Neni 2

Përkufizime

1. Për qëllime të kësaj Rregulloreje, zbatohen përkufizimet e mëposhtme:
 - a) “*marrëveshje kërkimi dhe zhvillimi*” do të thotë një marrëveshje e lidhur ndërmjet dy ose më shumë palëve për kushtet sipas së cilave këto palë synojnë një nga sa vijon:
 - (i) kërkimin dhe zhvillimin e përbashkët të produkteve të kontratës ose të teknologjive të kontratës që:
 - nuk përfshin shfrytëzimin e përbashkët të rezultateve të këtij kërkimi dhe zhvillimi; *ose*
 - përfshin shfrytëzimin e përbashkët të rezultateve të këtij kërkimi dhe zhvillimi;
 - (ii) kërkimin dhe zhvillimin me pagesë të produkteve të kontratës ose të teknologjive të kontratës që:
 - nuk përfshin shfrytëzimin e përbashkët të rezultateve të këtij kërkimi dhe zhvillimi; *ose*

¹(32023R1066) Rregullorja e Komisionit (BE) 2023/1066 e 1 qershorit 2023 mbi zbatimin e Nenit 101(3) të Traktatit për Funkcionimin e Bashkimit Evropian në kategori të caktuara të marrëveshjeve të kërkit dhe zhvillimit C/2023/3443.

- përfshin shfrytëzimin e përbashkët të rezultateve të këtij kërkimi dhe zhvillimi;
- (iii) shfrytëzimin e përbashkët të rezultateve të kërkimit dhe zhvillimit të produkteve të kontratës ose teknologjive të kontratës të kryer në përputhje me një marrëveshje paraprake që bie në pikën (i) midis të njëjtave palë;
- (iv) shfrytëzimin e përbashkët të rezultateve të kërkimit dhe zhvillimit të produkteve të kontratës ose teknologjive të kontratës të kryer në përputhje me një marrëveshje paraprake që bie në pikën (ii) midis të njëjtave palë;
- b) "*marrëveshje*" ka kuptimin që i është dhënë në nenin 3, paragrafi 4 i Ligjit;
- c) "*kërkim dhe zhvillim*" do të thotë veprimtaritë që synojnë përvetësimin e *know-how* në lidhje me produktet, teknologjitë ose proceset, kryerjen e analizave teorike, studimit sistematik ose eksperimentimit, duke përfshirë prodhimin eksperimental dhe demonstrues, testimin teknik të produkteve ose proceseve, krijimi i objekteve të nevojshme deri në shkallën demonstruese dhe fitimin e të drejtave të pronësisë intelektuale për rezultatet;
- d) "*produkt*" do të thotë një mall ose një shërbim, duke përfshirë mallrat ose shërbimet ndërmjetëse dhe mallrat ose shërbimet përfundimtare;
- e) "*teknologji e kontratës*" do të thotë një teknologji ose proces që rezulton nga kërkimi dhe zhvillimi i përbashkët ose me pagesë;
- f) "*produkt i kontratës*" do të thotë një produkt që rezulton nga kërkimi dhe zhvillimi i përbashkët ose me pagesë ose i prodhuar duke zbatuar teknologjitë e kontratës;
- g) "*shfrytëzim i rezultateve*" do të thotë prodhimi ose shpërndarja e produkteve të kontratës, ose zbatimi i teknologjive të kontratës, ose transferimi ose licencimi i të drejtave të pronësisë intelektuale, ose komunikimi i *know-how* të kërkuar për një prodhim, shpërndarje ose zbatim të tillë;
- h) "*të drejtat e pronësisë intelektuale*" përfshijnë të drejtat e pronësisë industriale, për shembull patentat dhe markat tregtare, si dhe të drejtat e autorit dhe të drejtat e lidhura me to;
- i) "*know-how*" do të thotë një paketë informacioni praktik, që është rezultat i përvojës dhe testimit, i cili është sekret, thelbësor dhe i identifikuar:
 - (i) "sekret" do të thotë se *know-how* nuk është përgjithësisht i njohur ose lehtësisht i arritshëm;
 - (ii) "thelbësor" do të thotë se *know-how* është i rëndësishëm dhe i dobishëm për prodhimin e produkteve të kontratës ose zbatimin e teknologjive të kontratës;
 - (iii) "i identifikuar" do të thotë që *know-how* përshkruhet në një mënyrë mjaftueshëm të plotë, në mënyrë që të mundësohet verifikimi i plotësimi të kriterëve të të qenit sekret dhe thelbësor;
- j) "*i përbashkët*", në kontekstin e veprimtarive të kryera sipas një marrëveshjeje kërkimi dhe zhvillimi, nënkupton veprimtaritë ku puna e përfshirë:
 - (i) kryhet nga një ekip, organizatë ose ndërmarrje e përbashkët;
 - (ii) i besohet bashkërisht një palë të tretë; ose
 - (iii) ndahet ndërmjet palëve nëpërmjet specializimit në kontekstin e kërkimit dhe zhvillimit ose specializimit në kontekstin e shfrytëzimit;
- k) "*specializim në kontekstin e kërkimit dhe zhvillimit*" do të thotë që secila nga palët është e përfshirë në veprimtaritë e kërkimit dhe zhvillimit të mbuluara nga marrëveshja e kërkimit dhe zhvillimit dhe ato e ndajnë punën e kërkimit dhe zhvillimit midis tyre në çfarëdo mënyre që ato e konsiderojnë të përshtatshme; kjo nuk përfshin kërkimin dhe zhvillimin me pagesë;

- l) *"specializim në kontekstin e shfrytëzimit"* do të thotë që palët ndajnë mes tyre detyra individuale si prodhimi ose shpërndarja, ose vendosin kufizime ndaj njëra-tjetrës në lidhje me shfrytëzimin e rezultateve, të tilla si kufizime në lidhje me territore të caktuara, klientë ose fusha e përdorimi; kjo përfshin një skenar ku vetëm njëra palë prodhon dhe shpërndan produktet e kontratës ose zbaton teknologjitë e kontratës në bazë të një licence ekskluzive të dhënë nga palët e tjera;
 - m) *"kërkim dhe zhvillim me pagesë"* do të thotë kërkimi dhe zhvillimi që kryhet nga një palë dhe financohet nga një palë financuese;
 - n) *"palë financuese"* do të thotë një palë që financon kërkimin dhe zhvillimin me pagesë, ndërkohë që nuk kryen vetë asnjë nga aktivitetet e kërkimit dhe zhvillimit;
 - o) *"ndërmarrje konkurruese"* do të thotë një konkurrent aktual ose potencial;
 - (i) *"konkurrent aktual"* do të thotë një ndërmarrje që furnizon një produkt, teknologji ose proces që mund të përmirësohet nga, këmbëhet me ose zëvendësohet nga produkti i kontratës ose teknologjia e kontratës në tregun përkatës gjeografik;
 - (ii) *"konkurrent potencial"* do të thotë një ndërmarrje që, në mungesë të marrëveshjes së kërkimit dhe zhvillimit, do të kishte gjasa, në baza reale dhe jo thjesht si një mundësi teorike, brenda jo më shumë se 3 viteve, të kryente investimet e nevojshme shtesë ose të përballonte kostot e nevojshme për të furnizuar një produkt, teknologji ose proces të aftë për t'u përmirësuar nga, këmbyer me ose zëvendësuar nga produkti i kontratës ose teknologjia e kontratës në tregun përkatës gjeografik;
 - p) *"treg përkatës i produktit"* do të thotë tregu përkatës për produktet që mund të përmirësohen nga, këmbëhen me ose zëvendësohen nga produktet e kontratës;
 - q) *"treg përkatës i teknologjisë"* do të thotë tregu përkatës për teknologjitë dhe proceset që mund të përmirësohen nga, këmbëhen me ose zëvendësohen nga teknologjitë e kontratës;
 - r) *"shitje aktive"* do të thotë të gjitha format e shitjes, përveç shitjeve pasive;
 - s) *"shitje pasive"* do të thotë shitjet e bëra në përgjigje të kërkesave të pakërkjuara nga klientët individualë duke përfshirë shpërndarjen e produkteve për klientin, ku shitja nuk është filluar duke shënjestruar aktivisht klientin, grupin ose territorin e klientëve, dhe duke përfshirë shitjet që rezultojnë nga pjesëmarrja në prokurimet publike ose përgjigjia ndaj ftesave private për tender;
 - t) *"Komisioni i Konkurrencës"* do të thotë struktura vendimmarrëse e Autoritetit të Konkurrencës.
2. Për qëllimet e kësaj Rregulloreje, termat *"ndërmarrje"* dhe *"palë"* do të përfshijnë ndërmarrjet e tyre përkatëse të lidhura. *"Ndërmarrje të lidhura"* do të thotë:
- a) ndërmarrjet tek të cilat një palë në marrëveshjen e kërkimit dhe zhvillimit, drejtpërdrejt ose tërthorazi, ka një ose më shumë prej të drejtave apo kompetencave vijuese:
 - (i) kompetencën për të ushtruar më shumë se gjysmën e të drejtave të votës;
 - (ii) kompetencën për të emëruar më shumë se gjysmën e anëtarëve të këshillit mbikëqyrës, këshillit të administrimit ose organeve që përfaqësojnë ligjërisht ndërmarrjen;
 - (iii) të drejtën e administrimit të veprimtarisë së ndërmarrjes;
 - b) ndërmarrjet të cilat drejtpërdrejt ose tërthorazi kanë, mbi një palë në marrëveshjen e kërkimit dhe zhvillimit, të drejtat ose kompetencat e renditura në germën a);
 - c) ndërmarrjet në të cilat një ndërmarrje e përmendur në germën b) ka, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të drejtat ose kompetencat e renditura në germën a);
 - d) ndërmarrjet në të cilat një palë në marrëveshjen e kërkimit dhe zhvillimit së bashku me një ose më shumë nga ndërmarrjet e përmendura në germat a), b) ose c), ose në të cilat dy ose

më shumë nga ndërmarrjet e përmendura në germat a), b) ose c), kanë së bashku të drejtat ose kompetencat e renditura në germën a);

- e) ndërmarrjet në të cilat të drejtat ose kompetencat e renditura në germën a) mbahen bashkërisht nga:
 - (i) palët në marrëveshjen e kërimit dhe zhvillimit ose ndërmarrjet e tyre përkatëse të lidhura të përmendura në germat a) deri d), ose
 - (ii) një ose më shumë nga palët në marrëveshjen e kërimit dhe zhvillimit ose një ose më shumë nga ndërmarrjet e tyre të lidhura të përmendura në germat a) deri d) dhe një ose më shumë palë të treta.

Neni 3

Përfshirja

1. Në bazë të nenit 5 dhe 6 të Ligjit dhe në varësi të dispozitave të kësaj Rregulloreje, neni 4 i Ligjit nuk do të zbatohet për marrëveshjet e kërimit dhe zhvillimit.
2. Përfshirja e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni zbatohet deri në masën që marrëveshjet e kërimit dhe zhvillimit përmbajnë kufizime të konkurrencës që bien në objektin e nenit 4 të Ligjit.
3. Përfshirja e përcaktuar në pikën 1 të këtij neni zbatohet edhe për marrëveshjet e kërimit dhe zhvillimit që përmbajnë dispozita që lidhen me transferimin ose licencimin e të drejtave të pronësisë intelektuale tek një ose më shumë nga palët ose tek një entitet i krijuar nga palët për të kryer kërkimin dhe zhvillimin e përbashkët ose me pagesë, ose për shfrytëzimin e përbashkët të rezultateve, me kusht që këto dispozita të lidhen drejtpërdrejt dhe të jenë të nevojshme për zbatimin e marrëveshjes dhe të mos përbëjnë objektin kryesor të marrëveshjes.

Neni 4

Kushtet për përfshirje

1. Përfshirja e përcaktuar në nenin 3 të kësaj Rregulloreje, zbatohet në varësi të kushteve të përcaktuara në pikat 2, 3, dhe 4 të këtij neni.
2. Marrëveshja e kërimit dhe zhvillimit duhet të përcaktojë që të gjitha palët kanë qasje të plotë në rezultatet përfundimtare të kërimit dhe zhvillimit të përbashkët ose me pagesë për qëllime kërkitore dhe zhvillimi të mëtejshëm dhe për qëllime shfrytëzimi.
3. Qasja e parashikuar në pikën 2 të kësaj Rregulloreje duhet:
 - a) të përfshijë çdo të drejtë të pronësisë intelektuale dhe *know-how* që rezulton;
 - b) të jepet sapo të bëhen të disponueshme rezultatet e kërimit dhe zhvillimit.
4. Kur marrëveshja e kërimit dhe zhvillimit parashikon që palët kompensojnë njëra-tjetrën për dhënien e qasjes në rezultatet për qëllime kërkitore dhe zhvillimi të mëtejshëm ose për qëllime shfrytëzimi, kompensimi nuk duhet të jetë aq i lartë sa të pengojë efektivisht një qasje të tillë.
5. Institutet kërkimore, organet akademike ose ndërmarrjet që ofrojnë kërkimin dhe zhvillimin si shërbim tregtar pa qenë normalisht aktive në shfrytëzimin e rezultateve, mund të bien dakord të kufizojnë përdorimin e rezultateve për qëllime të kërimit dhe zhvillimit të mëtejshëm.
6. Kur palët kufizojnë të drejtat e tyre të shfrytëzimit në përputhje me këtë Rregullore, veçanërisht kur ato specializohen në kontekstin e shfrytëzimit, qasja në rezultate për qëllime shfrytëzimi mund të kufizohet sipas rrethanave.

Neni 5

Qasja në *know-how* të mëparshme

1. Kur marrëveshja e kërkimit dhe zhvillimit nuk përfshin shfrytëzimin e përbashkët të rezultateve, përjashtimi i përcaktuar në nenin 3 të kësaj Rregulloreje do të zbatohet në përputhje me kushtet e përcaktuara në pikat 2 dhe 3 të këtij neni.
2. Marrëveshja duhet të përcaktojë që secilës palë do t'i jepet qasje në çdo *know-how* të mëparshëm të palëve të tjera, nëse ky *know-how* është i domosdoshëm për qëllime të shfrytëzimit të rezultateve.
3. Kur marrëveshja parashikon që palët kompensojnë njëra-tjetrën për dhënien e qasjes në *know-how* e tyre të mëparshme, kompensimi nuk duhet të jetë aq i lartë sa të pengojë efektivisht një qasje të tillë.

Neni 6

Shfrytëzimi i përbashkët

1. Përjashtimi i përcaktuar në nenin 3 të kësaj Rregulloreje zbatohet me kusht që çdo shfrytëzim i përbashkët t'i referohet vetëm rezultateve që plotësojnë të dyja kushtet e mëposhtme:
 - a) rezultatet janë të domosdoshme për prodhimin e produkteve të kontratës ose zbatimin e teknologjive të kontratës;
 - b) rezultatet mbrohen nga të drejtat e pronësisë intelektuale ose përbëjnë *know-how*.
2. Kur një ose më shumë palë ngarkohen me prodhimin e produkteve të kontratës me anë të specializimit në kontekstin e shfrytëzimit, përjashtimi i përcaktuar në nenin 3 të kësaj Rregulloreje do të zbatohet me kusht që atyre palëve t'u kërkohej të përmbushin porosi të palëve të treta për furnizimin me produkte të kontratës, përveç rasteve kur zbatohet një nga sa vijon:
 - a) marrëveshja e kërkimit dhe zhvillimit parashikon gjithashtu që shpërndarja të kryhet nga një ekip, organizatë ose ndërmarrje e përbashkët ose t'i besohet bashkërisht një pale të tretë;
 - b) palët kanë rënë dakord që vetëm pala që prodhon produktet e kontratës mund t'i shpërndajë ato.

Neni 7

Kufijtë e pjesës së tregut dhe kohëzgjatja e përjashtimit

1. Kur dy ose më shumë nga palët janë ndërmarrje konkurruese sipas kuptimit të nenin 2, pika 1, germa (o) e kësaj Rregulloreje, përjashtimi i vendosur në nenin 3 të kësaj Rregulloreje do të zbatohet për kohëzgjatjen e kërkimit dhe zhvillimit nëse, në momentin e lidhjes së marrëveshjes:
 - a) për marrëveshjet e kërkimit dhe zhvillimit të përmendura në nenin 2, pika 1, germa (a), nënndarjet (i) dhe (iii) të kësaj Rregulloreje, pjesa e kombinuar e tregut e palëve në marrëveshje nuk kalon 25% në tregjet përkatëse të produktit dhe teknologjisë;
 - b) për marrëveshjet e kërkimit dhe zhvillimit të përmendura në nenin 2, pika 1, germa (a), nënndarjet (ii) dhe (iv) të kësaj Rregulloreje, pjesa e kombinuar e tregut e palës financuese dhe të gjitha palëve me të cilat pala financuese ka lidhur marrëveshjet e kërkimit dhe zhvillimit në lidhje me të njëjtat produkte të kontratës ose teknologji të kontratës nuk kalon 25% në tregjet përkatëse të produktit dhe teknologjisë.
2. Kur palët nuk janë ndërmarrje konkurruese sipas kuptimit të nenit 2, pika 1, germa (o) të kësaj Rregulloreje, përjashtimi i vendosur në nenin 3 të kësaj Rregulloreje do të zbatohet për kohëzgjatjen e kërkimit dhe zhvillimit.

3. Për marrëveshjet e kërkimit dhe zhvillimit ku rezultatet shfrytëzohen bashkërisht, përjashtimi i përcaktuar në nenin 3 të kësaj Rregulloreje do të vazhdojë të zbatohet për 7 vjet nga momenti kur produktet e kontratës ose teknologjitë e kontratës hidhen për herë të parë në treg, nëse kushtet e parashikuara në pikat 1 ose 2 të këtij neni plotësohen në momentin e lidhjes së marrëveshjes së përmendur në nenin 2, pika 1, germa (a), nënndarjet (i) ose (ii) të kësaj Rregulloreje. Që marrëveshjet e kërkimit dhe zhvillimit të përmendura në nenin 2, pika 1, germa (a), nënndarjet (iii) ose (iv) të kësaj Rregulloreje të përfitojnë nga një përjashtim i tillë i vazhduar, kushtet e parashikuara në pikat 1 ose 2 të këtij neni duhet të plotësohen në kohën kur është lidhur marrëveshja paraprase e përmendur në nenin 2, pika 1, germa (a), nënndarjet (i) ose (ii) të kësaj Rregulloreje.
4. Pas përfundimit të periudhës 7-vjeçare të përmendur në pikën 3 të këtij neni, përjashtimi i përcaktuar në nenin 3 të kësaj Rregulloreje do të vazhdojë të zbatohet për aq kohë sa:
 - a) për marrëveshjet e kërkimit dhe zhvillimit të përmendura në nenin 2, pika 1, germa (a), nënndarjet (i) dhe (iii) të kësaj Rregulloreje, pjesa e kombinuar e tregut e palëve në marrëveshje nuk kalon 25% në tregjet përkatëse të cilave u përkasin produktet e kontratës ose teknologjitë e kontratës;
 - b) për marrëveshjet e kërkimit dhe zhvillimit të përmendura në nenin 2, pika 1, germa (a), nënndarjet (ii) dhe (iv) të kësaj Rregulloreje, pjesa e kombinuar e tregut e palës financuese dhe të gjitha palëve me të cilat pala financuese ka lidhur marrëveshjet e kërkimit dhe zhvillimit në lidhje me të njëjtat produkte të kontratës ose teknologji të kontratës nuk kalon 25% në tregjet përkatëse të cilave u përkasin produktet e kontratës ose teknologjitë e kontratës.
5. Nëse pjesa e kombinuar e tregut të palëve përkatëse nuk e kalon kufirin përkatës të përmendur në pikën 4 të këtij neni në fund të periudhës 7-vjeçare të përmendur në pikën 3 të këtij neni, por më pas rritet mbi këtë prag, përjashtimi i përcaktuar në nenin 3 të kësaj Rregulloreje do të vazhdojë të zbatohet për një periudhë prej 2 vitesh kalendarike radhazi pas vitit në të cilin është tejkaluar për herë të parë pragu përkatës i pjesës së tregut.

Neni 8

Përlllogaritja dhe zbatimi i kufijve të pjesës së tregut

1. Për qëllimin e zbatimit të kufijve të pjesës së tregut të parashikuar në nenin 7, pika 1 dhe 4 e kësaj Rregulloreje, zbatohen rregullat e përcaktuara në pikat 2, 3 dhe 4 të këtij neni.
2. Pjesët e tregut do të llogariten në bazë të vlerës së shitjeve në treg ose, nëse të dhënat e vlerës së shitjeve në treg nuk janë të disponueshme, në bazë të vëllimeve të shitjeve në treg. Nëse të dhënat për vëllimet e shitjeve në treg nuk janë të disponueshme, mund të përdoren vlerësime të bazuara në informacione të tjera të besueshme të tregut, duke përfshirë shpenzimet për kërkimin dhe zhvillimin, ose aftësitë e kërkimit dhe zhvillimit.
3. Pjesët e tregut do të llogariten në bazë të të dhënave të vitit kalendarik paraardhës. Nëse viti kalendarik paraardhës nuk është përfaqësues i pozicionit të palëve në tregun(gjet) përkatës(e), pjesa e tregut do të llogaritet si një mesatare e pjesëve të tregut të palëve për 3 vitet kalendarike paraardhëse.
4. Pjesa e tregut e zotëruar nga ndërmarrjet e përmendura në nenin 2, pika 2, germa (e) e kësaj Rregulloreje, do t'i ndahet në mënyrë të barabartë secilës ndërmarrje që ka një ose më shumë nga të drejtat ose kompetencat e renditura në nenin 2, pika 2, germa (a) e kësaj Rregulloreje.

Neni 9

Kufizimet të rënda

Përfshirja e vendosur në nenin 3 të kësaj Rregulloreje nuk do të zbatohet për marrëveshjet e kërkimit dhe zhvillimit, të cilat, drejtpërdrejt ose tërthorazi, të izoluara ose në kombinim me faktorë të tjerë nën kontrollin e palëve, kanë si objekt një nga kufizimet e mëposhtme:

1. Kufizimin e lirisë së palëve për të kryer kërkim dhe zhvillim në mënyrë të pavarur ose në bashkëpunim me palë të treta:
 - a) në një fushë që nuk lidhet me fushën që mbulon marrëveshja e kërkimit dhe zhvillimit; *ose*
 - b) pas përfundimit të kërkimit dhe zhvillimit të përbashkët ose me pagesë, në fushën që mbulon marrëveshja e kërkimit dhe zhvillimit ose në një fushë të lidhur me të;
2. Kufizimin e prodhimit ose shitjeve, me përjashtim të:
 - a) vendosjes së objektivave të prodhimit, ku shfrytëzimi i përbashkët i rezultateve përfshin prodhimin e përbashkët të produkteve të kontratës;
 - b) vendosjes së objektivave të shitjeve, ku shfrytëzimi i përbashkët i rezultateve:
 - (i) përfshin shpërndarjen e përbashkët të produkteve të kontratës ose licencimin e përbashkët të teknologjive të kontratës; *dhe*
 - (ii) kryhet nga një ekip, organizatë ose ndërmarrje e përbashkët, ose i është besuar bashkërisht një palë të tretë;
 - c) praktikave që përbëjnë specializim në kontekstin e shfrytëzimit;
 - d) kufizimit të lirisë së palëve për të prodhuar, shitur, transferuar ose licencuar produkte, teknologji ose procese që konkurojnë me produktet e kontratës ose teknologjitë e kontratës gjatë periudhës për të cilën palët kanë rënë dakord të shfrytëzojnë së bashku rezultatet;
3. Fiksimin e çmimeve në shitjen e produkteve të kontratës ose licencimit të teknologjive të kontratës tek palët e treta, me përjashtim të fiksimit të çmimeve për t'u paguar nga klientët e drejtpërdrejtë ose fiksimit të tarifave të licencës për t'u paguar nga të licencuarit e drejtpërdrejtë ku shfrytëzimi i përbashkët i rezultateve:
 - a) përfshin shpërndarjen e përbashkët të produkteve të kontratës ose licencimin e përbashkët të teknologjive të kontratës; *dhe*
 - b) kryhet nga një ekip, organizatë ose ndërmarrje e përbashkët, ose i është besuar bashkërisht një palë të tretë;
4. Kufizimin e territorit në të cilin, ose të klientëve të cilëve, palët mund t'u shesin pasivisht produktet e kontratës ose t'u licencojnë teknologjitë e kontratës, me përjashtim të kërkesës për të licencuar ekskluzivisht rezultatet e kërkimit dhe zhvillimit tek një tjetër palë;
5. Kufizimin e shitjeve aktive të produkteve të kontratës ose teknologjive të kontratës në territore ose klientë të cilët nuk i janë caktuar ekskluzivisht njëres prej palëve me anë të specializimit në kontekstin e shfrytëzimit;
6. Kushtin për të refuzuar plotësimin e kërkesës nga klientët në territoret përkatëse të palëve, ose nga klientët e caktuar ndryshe ndërmjet palëve nëpërmjet specializimit në kontekstin e shfrytëzimit, ku klientë të tillë do të tregtonin produktet e kontratës në territore të tjera brenda vendit.
7. Kushtin për ta bërë të vështirë për përdoruesit ose rishitësit marrjen e produkteve të kontratës nga rishitës të tjerë brenda tregut.

Neni 10

Kufizime të tjera

1. Përjashtimi i përcaktuar në nenin 3 të kësaj Rregulloreje nuk zbatohet për detyrimet e mëposhtme në marrëveshjet e kërkimit dhe zhvillimit:
 - a) detyrimi për të mos kundërshtuar:
 - (i) pas përfundimit të kërkimit dhe zhvillimit, vlefshmërinë e të drejtave të pronësisë intelektuale të cilat:
 - palët mbajnë në treg; *dhe*
 - janë të rëndësishme për kërkimin dhe zhvillimin; *ose*
 - (ii) pas mbarimit të marrëveshjes së kërkimit dhe zhvillimit, vlefshmërinë e të drejtave të pronësisë intelektuale të cilat:
 - palët mbajnë në treg; *dhe*
 - mbrojnë rezultatet e kërkimit dhe zhvillimit;
 - b) detyrimin për të mos u dhënë licenca palëve të treta për të prodhuar produktet e kontratës ose për të zbatuar teknologjitë e kontratës, përveç nëse marrëveshja parashikon shfrytëzimin e rezultateve të kërkimit dhe zhvillimit të përbashkët ose me pagesë nga një ose më shumë prej palëve dhe një shfrytëzim i tillë bëhet në treg kundrejt palëve të treta.
2. Pika 1, germa (a) e këtij neni, nuk cenon mundësinë për të parashikuar mbarimin e marrëveshjes së kërkimit dhe zhvillimit në rast se njëra nga palët kundërshton vlefshmërinë e të drejtave të pronësisë intelektuale të përmendura në pikën 1, gërma (a), nënndarjet (i) dhe (ii) të këtij neni.
3. Nëse marrëveshja e kërkimit dhe zhvillimit përfshin ndonjë nga kufizimet e përmendura në pikën 1 të këtij neni, përjashtimi i përcaktuar në nenin 3 të kësaj Rregulloreje do të vazhdojë të zbatohet për pjesën e mbetur të marrëveshjes së kërkimit dhe zhvillimit, me kusht që kufizimet që nuk përjashtohen mund të shpëputen nga ajo pjesë e mbetur dhe me kusht që të plotësohen kushtet e tjera të kësaj Rregulloreje.

Neni 11

Revokimi në raste individuale

1. Në përputhje me nenet 48 deri 51 të Ligjit, Komisioni i Konkurrencës mund të revokojë përfitimin nga përjashtimi sipas kësaj Rregulloreje, nëse konstaton në ndonjë rast të veçantë se një marrëveshje kërkimi dhe zhvillimit ndaj së cilës zbatohet përjashtimi i vendosur nga kjo Rregullore ka gjithsesi efekte që janë të papajtueshme me nenin 5 dhe 6 të Ligjit.
2. Komisioni i Konkurrencës mund të revokojë përfitimin nga përjashtimi sipas kësaj Rregulloreje, në përputhje me nenet 48 deri 51 të Ligjit, në veçanti kur:
 - a) ekzistenca e një marrëveshjeje kërkimi dhe zhvillimi kufizon në thelb hapësirën për palët e treta për të kryer kërkime dhe zhvillime në fushën(at) që lidhen me produktet e kontratës ose teknologjitë e kontratës;
 - b) ekzistenca e një marrëveshjeje kërkimi dhe zhvillimi kufizon në mënyrë thelbësore aksesin e palëve të treta në tregun përkatës për produktet e kontratës ose teknologjitë e kontratës;
 - c) palët nuk i shfrytëzojnë rezultatet e kërkimit dhe zhvillimit të përbashkët ose të paguar përballë palëve të treta pa ndonjë arsye objektivist të vlefshme;
 - d) produktet e kontratës ose teknologjitë e kontratës nuk i nënshtrohen konkurrencës efektive në tërësi ose në një pjesë të konsiderueshme të tregut; ose

- e) ekzistenca e marrëveshjes së kërkimit dhe zhvillimit do të kufizonte ndjeshëm konkurrencën e inovacionit në një fushë të caktuar.

Neni 12

Dispozita kalimtare

Ndalimi i parashikuar në nenin 4 të Ligjit nuk do të zbatohet gjatë periudhës prej dy vitesh duke filluar nga hyrja në fuqi e kësaj Rregulloreje në lidhje me marrëveshjet që janë në fuqi në momentin e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje, të cilat nuk plotësojnë kushtet për përjashtim të parashikuara në këtë Rregullore, por të cilat plotësojnë kushtet për përjashtim të parashikuara në Rregulloren *“Për përjashtimin e kategorive të marrëveshjeve të kërkimit dhe zhvillimit”*, e miratuar me Vendimin Nr. 187, datë 03 maj 2011, të Komisionit të Konkurrencës.

Neni 13

Shfuqizime

Rregullorja *“Për përjashtimin e kategorive të marrëveshjeve të kërkimit dhe zhvillimit”*, e miratuar me Vendimin Nr. 187, datë 03 maj 2011, të Komisionit të Konkurrencës shfuqizohet.

Neni 14

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi menjëherë.